BULETINI MJEDISOR

Numri #4 (Tetor 2011) **Abonohu në: www.ks.undp.org**

NË KËTË NUMËR

LAJME NGA VENDI

- Letër nga Ambasadorët e Vegjël të Mjedisit
- 'Shkolla e gjelbër' në Prishtinë e vetmja e këtij lloji në Ballkan
- Shtohen hapësirat e gjelbra nëpër zonat urbane të Kosovës
- Qeveria Japoneze ndihmon Kosovën
- Fushatë vetëdijësimi për mbetjet industriale në Mitrovicë

LAJME NGA REGJIONI

- Dita e Liqenit të Ohrit bashkon çiklistët

LAJME NGA BOTA

- Rritet emisioni i CO_2 në atmosferë

I nderuari lexues,

Po sjellim tek ju numrin e katërt të buletinit mjedisor. Llojllojshmëria e temave dhe aktivitetet e grupeve te ndryshme për mbrojtjen e mjedisit e karakterizojnë këtë numër të buletinit. Kësaj radhe në qendër të vëmendjes kemi vënë shkollat, fëmijët dhe aktivitetet edukative dhe ndërgjegjësuese për mbrojtjen e mjedisit. Edhe aktivitetet e komunave në shtimin e sipërfaqeve të gjelbra dhe përkrahja e iniciativave mjedisore nga ana e komunitetit të sportistëve për përmirësimin e gjendjes së mjedisit janë pjesë integrale e buletinit. Nuk mungojnë as informacionet për kontributin e donatorëve për të ndihmuar në përmirësimin e gjendjes së mjedisit në Kosovë. Nga regjioni mund të lexoni për një aktivitet që ka për qëllim promovimin e përpjekjeve ndërregjionale për mbrojtjen e mjedisit ndërsa nga bota një informacion për shqetësimin e institucioneve kërkimore për rritjen e nivelit të emisioneve të dioksidit të karbonit ne nivelin global. As kësaj radhe nuk mungojnë këshi- llat për veprimet që mund të bëhen për të ndihmuar në mbrojtjen e mjedisit, kurse informacionet e përmbledhura dhe ngjarjet më të rëndësishme nga kalendari mjedisor do të vazhdojnë të jenë pjesë e përhershme e buletinit tonë.

Ekipi Redaktues

LETËR NGA AMBASADORËT E VEGJËL TË MJEDISIT

Fëmijët e rrjetit 'Ambasadorët e vegjël të mjedisit', i kanë drejtuar një letër përfaqësuesve të institucioneve të Kosovës, në të cilën kanë shprehur shqetësimin e tyre për gjendjen e mjedisit. Në letrën e tyre ndër të tjera ata shkruajnë:

"E duam të kaltër dhe të kthjellët qiellin tonë. I duam të pastër lumenjtë dhe burimet tona. E duam pjellore dhe të shëndetshme tokën e bukës sonë. I duam të gjelbra dhe plot gjallesa pyjet tona. I duam pa mbeturina dhe pa zhurmë qytetet tona. Duam më shumë hapësira për lojë dhe argëtim. Mos na shkatërroni ardhmërinë tonë. E duam Kosovën të pastër".

Rrjeti i ambasadorëve të vegjël të mjedisit është krijuar në kuadër të një projekti që po implementohet nga Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim-ATRC.

Në projekt janë përfshirë rreth 60 shkolla fillore në të gjitha komunat e Kosovës. Projekti është mbështetur nga Ambasada Amerikane në Prishtinë dhe ka për qëllim të rris nivelin e edukimit dhe ndërgjegjësimit të fëmijëve të shkollave fillore për mbrojtjen e mjedisit.



BULETINI MJEDISOR

INFORMATA TË PËRMBLEDHURA

◊ Sipërfaqja ujëmbledhëse topografike e Kosovës është 11 645 km^2.

◊ Pjesa më e madhe e lumenjve të Kosovës i takojnë pellgut të Detit të Zi me 50.7%, Detit Adriatik i takojnë 43.5% ndërsa Detit Egje 5.8%.

◊ Lumi Drini i Bardhë ka gjatësinë më të madhe në kilometra brenda territorit të Kosovës me 122 km, ndërsa Lumëbardhi i Prizrenit më të voglën me 31 km.

◊ Rreth 47% e territorit të Kosovës konsiderohet si tokë pyjore. Prej tyre pjesën më të madhe e përbejnë pyjet e ulëta (42 %), rreth 15 % janë pyje të larta, 20 % pyje të degraduara dhe 23% janë shkurre dhe kaçuba.

'SHKOLLA E GJELBËR' NË PRISHTINË E VETMJA E KËTIJ LLOJI NË BALLKAN

Në maj të këtij viti është lëshuar në funksion "shkolla e gjelbër" në Prishtinë. Koncepti i kësaj shkolle është bazuar në principet e arkitekturës së gjelbër që respekton shfrytëzuesit dhe mjedisin natyror. Shkolla është ndërtuar me bashkëfinancim të USAID-së dhe Komunës së Prishtinës. Aktualisht në këtë shkollë vijojnë mësimet 350 nxënës. Objekti është ndër shkollat më moderne në Kosovë, me kushte mësimi sipas standardeve bashkëkohore; ka 10 dhoma mësimi dhe është e pajisur me kabinet të fizikës, kimisë, biologjisë dhe informatikës.



Dimensioni i veçant mjedisor i këtij projekti qëndron në aplikimin e materialeve ndërtimore termoizoluese, shfrytëzimin e energjisë gjeo-termale për ngrohje dhe ftohje të dyshemesë, mureve dhe të tavanit, përdorimi i paneleve solare për ujë të nxehtë sanitar, përdorimi i sistemit efiçient ndriçues që konsumon më pak energji dhe aplikimi i modulit BMS për të kontrolluar konsumin e përgjithshëm të energjisë për ndriçim, ngrohje dhe ftohje qendrore. Vlerësohet se kursimi i përgjithshëm i energjisë mund të arrijë deri në 40%. Kulmi i kësaj shkollë është i rrafshët, mbi të cilin mund të mbillen bimë që do të tërheqin zogjtë. Po ashtu uji i shiut mund të mblidhet nga kulmi dhe oborri i shkollës dhe përmes trajtimit në sistemin e filtrave, uji mund të përdoret sërish për nevoja sanitare. Panelet solare dhe bimët e rritura mbi kulmin e gjelbër mund të shfrytëzohen për qëllime studimore nga nxënësit e shkollës.

SHTOHEN HAPËSIRAT E GJELBRA NËPËR ZONAT URBANE TË KOSOVËS

Gjatë këtij viti ka pasur një trend pozitiv të shtimit të sipërfaqeve të gjelbra në disa zona urbane të Kosovës. Kështu në kryeqytetin e Kosovës në Prishtinë, një deponi në lagjen "Kodra e Trimave", është shndërruar në park. Më herët ky vend ishte përplot mbeturina, të cilat për kryeqytetin përkatësisht lagjen periferike "Kodra e Trimave" paraqitnin një shëmti dhe rrezik për shëndet. Por tani hapësira rreth 8 hektarësh është shndërruar në park.

Në të njëjtën kohë për të zgjeruar hapësirat gjelbëruese në qytetin e Prizrenit kanë ndihmuar përfaqësues të KFOR-it gjerman dhe turk. Ata kanë mbjellur drunj dekorativ brenda dhe jashtë kampit fushor të tyre. Numri i drunjve dekorativ para kampit fushor është shtuar me qëllim të sensibilizimit të qytetarëve për një mjedis më të shëndoshë, kanë pohuar përfaqësuesit e KFOR-it. Edhe komuna e Ferizajit me qëllim të shtimit të sipërfaqeve të gjelbëruara në zonën e qytetit, ka realizuar një projekt për mbjelljen e luleve në disa hapësira publike. Zyrtarët komunalë kanë thënë se ky projekt synon të mbulojë sa më shumë hapësira të gjelbëruara në pronat publike. Qytetarët e vlerësojnë lart këtë aksion të komunës dhe pohojnë se hapësirat e gjelbra i kanë dhënë një pamje më të bukur qytetit.



SI MUND TË NDIHMONI NË MBROJTJEN E MJEDISIT!

- Ndihmoni në kursimin e ujit!
- Përdor poçat efiçent elektrik dhe ndihmo në kursimin e energjisë.
- Ripërdor dhe riciklo në vend të blerjes së re.

BULETINI MJEDISOR

KALENDARI MJEDISOR

2011-ta, viti ndërkombëtar i pyjeve

12 Gusht
Dita ndrëkombëtare e të rinjëve

16 Shtatori
Dita ndërkombëtare për ruajtjen e shtresës së ozonit

18 Shtator
Dita botërore e monitorimit të ujit

Muaji Tetor
"Ec këmbë deri në shkollë"

16 Tetori
Dita botërore e ushqimit

17 Tetori
Dita ndërkombëtare për ç'rrënjosjen e varfërisë

QEVERIA JAPONEZE NDIHMON KOSOVËN

Adresimi i çështjeve mjedisore është një prej prioriteteve të Kosovës në orientimin e saj drejt integrimeve Evropiane. Në dialogun politik në mes Qeverisë së Kosovës dhe asaj të Japonisë në vitin 2009, sektori i mjedisit është identifikuar si një prej çështjeve kyçe zhvillimore. Bazuar në këto biseda me palën kosovare, Qeveria Japoneze është zotuar se do të financojë projektin që mëton përmirësimin e sistemit të grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave shtëpiake në Prishtinë, Prizren dhe disa komuna në regjionin e Prizrenit, përmes pajisjes së kompanive publike me 40 (katërdhjetë) kamionë kompaktësues transportues të mbeturinave, prej të cilëve 10 (dhjetë) do ti jepen komunës së Prishtinës dhe 30 (tridhjetë) të tjerë do t'i jepen komunës së Prizrenit. Përveç kësaj ndihme, Agjencioni Japonez për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA) dhe Qeveria e Kosovës do të fillojnë një projekt për ngritjen e kapaciteteve për menaxhimin e mbeturinave në Prizren. Gjatë kësaj periudhe tre vjeçare bashkëpunimi do të aplikohet qasja 3 R-she: Redukto – Ri-shfrytëzo dhe Riciklo. Ky projekt pos ngritjes së kapaciteteve lokale për menaxhimin e mbeturinave, do të fokusohet edhe në ngritjen e vetëdijes së qytetarëve për ruajtjen e mjedisit dhe pastrimin e hapësirave publike.



FUSHATË VETËDIJËSIMI PËR MBETJET INDUSTRIALE NË MITROVICË

Operimi i kompleksit minerar dhe metalurgjik Trepça ka lënë trashëgim mbetje të shumta industriale toksike që kërcënojnë dhjetëra mijëra fëmijë, gra dhe burra në regjionin e Mitrovicës. Këto mbetje në të kaluarën janë deponuar në afërsi të zonave të banuara dhe të lumenjëve, duke konsideruar pak apo asnjë aspekt mjedisor. Efluentët acidik, emisionet e pluhurit, deponitë e pa mirëmbajtura dhe jostabile janë kërcënim për të gjithë ata që jetojnë në afërsi. Në zonat më të kontaminuara, lumenjët janë të ndotur, arat e punueshme përhapin metale të rënda në produktet ushqimore, e ajri përmban pluhur me përqëndrim të lartë të metaleve të rënda.

Deponia e mbetjeve industriale në Kelmend është në afërsi të qytetit të Mitrovicës dhe fshtrave Kelmend, Rahovë dhe Boletin. Fëmijët e këtyre lokaliteteve e shfrytëzojnë pellgun/liqenin e krijuar në këtë deponi për tu freskuar gjatë verës. Uji i këtij liqeni përmbanë përqëndrim të lartë të metaleve të rënda pasi në të derdhet uji i patrajtuar që del nga miniera e Stantërg-ut. Për këtë qëllim UNDP – sektori i mjedisit përmes OJQ-së mjedisore EKO TREPÇA ka organizuar një fushatë vetëdijësimi për nxënësit dhe prindërit në shkollat fillore të Rahovës dhe Boletinit. Fushata e vetëdijësimit kishte për qëllim informimin e nxënësve dhe prindërve për: burimet kryesore të kontaminimit me metale të rënda në regjionin e Mitrovicës; mbetjet industriale dhe ndikimi në mjedis dhe në shëndetin e njeriut; mënyrat e marrjes së metaleve të rënda nga njeriu dhe aplikimi i masave mbrojtëse për të parandaluar marrjen e metaleve të rënda. Pos fushatës së vetëdijësimit, në deponin e mbetjeve industriale në Kelmend janë instaluar edhe dy mbishkrime paralajmëruese për rrezikun e ekspozimit të drejtpërdrejtë ndaj mbetjeve industriale dhe freskimit në ujin e pellgut/liqenit të formuar. Kjo fushatë vetëdijësimi është vlerësuar lartë nga autoritet komunale dhe shkollat.



BULETINI MJEDISOR

DITA E LIQENIT TË OHRIT BASHKON ÇIKLISTËT NGA MAQEDONIA, SHQIPËRIA DHE KOSOVA

Dita e Liqenit të Ohrit shënohet çdo vit me 21 qershor nga tre qytetet Pogradec, Ohër dhe Strugë. Këtë vit kjo ngjarje bashkoi çiklistët kosovarë me ata struganë dhe pogradecarë për të parakaluar me biçikleta rreth liqenit. Kësaj feste, e cila bëhet më rotacion një vit në Pogradec një vit në Ohër dhe më pas në Strugë, iu bashkëngjit edhe Prishtina, nën organizimin e OJQ-së mjedisore "Ekolëvizja" në Prishtinë dhe Unioni i Ekologëve "Natyra" në Strugë. Në këtë ditë festive për Liqenin, tre kryetarët e komunave, Artan Shkëmbi – Pogradec, Ramiz Merko – Strugë dhe Aleksandër Petrevski - Ohër, përshëndetën mysafirët nga regjione të ndryshme duke kërkuar që të ruhet kjo pasuri që e ka krijuar natyra. OJQ Ekolëvizja, në shenjë përkrahjeje për këtë ditë, u dhuroi kryetarëve të komunave përkatëse pllakate po me te njëjtin mesazh për mbrojtjen e mjedisit "në bicikletë për liqenin". Ata falënderuan Ekolëvizjen për këtë iniciativë të mirë të ardhur nga Prishtina dhe shprehën gatishmërinë e tyre për bashkëpunim në të ardhmen për të shënuar aktivitetet e njëjta që kanë për qëllim ruajtjen e mjedisit ku jetojmë. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte promovimi i përpjekjeve te përbashkëta Shqipëri – Maqedoni - Kosovë për mbrojtjen e mjedisit.



RRITET EMISIONI I CO_2 NË ATMOSFERË

Ndryshimi i klimës pa kurrfarë dyshimi është sfida më e madhe mjedisore me të cilën po përballet bota. Në mesin e institucioneve prominente shkencore më nuk ka mëdyshje se ndyshimi i klimës i shkaktuar nga njeriu po ndodhë; çështja është se çfarë magnitude dhe sa të pariparueshme do të jënë pasojat. Në një çështje pajtohen të gjithë dhe tashmë është e qartë, se njeriu me veprimet e tij është shkaktari kryesor i ndryshimit të klimës. Edhe përkundër kësaj, emisionet e gazrave me efket serrë po rriten. Në tri dekadat e fundit emisionet e gazrave me efekt serrë janë rritur mesatarisht 1.6% çdo vit. Bazuar në projeksionet e bëra, me kuadrin ligjor dhe politikat mjedisore të aplikueshme, konsumi botëror i energjisë dhe prodhimi i bazuar në karburante fosilore, që është burimi kryesor i emisioneve të gazrave me efekt serrë, do vazhdojë të rritet. Në konferencën e mbajtur më 2010 mbi ndryshimet klimatike në Cancun të Meksikës, liderët botëror kishin rënë dakord se ishin të nevojshme masa urgjente për të ulur ndieshëm emisionet e karbonit në atmosferë. Edhe përkundër këtij dakordimi, emisioni i gazrave me efekt serrë vitin e kaluar ka shënuar rritje rekorde, pas rënies që ishte regjistruar në vitin 2009 si rezultat i krizës financiare, me 5% mbi rekordin e vitit 2008 - raporton Agjencioni Ndërkombëtar i Energjisë (IEA). Kina dhe India vlerësohet të jenë kontribuuesit kryesorë të rritjes, megjithëse shkarkimet janë rritur edhe në vendet e zhvilluara. Kjo rritje e shënuar e shkarkimeve të gazrave me efekt serrë vë në dyshim zotimin e qeverive përkatëse për të zvogëluar emisionet në shtetet e tyre dhe për të mos lejuar ngritjen globale të temperatures më shumë se 2 ^{0}C, që do të kishte pasoja katastrofale.

Për numrin e radhës 12/2011, abonohu në: www.ks.undp.org

Versioni online: http://www.kosovo.undp.org/?cid=2,176

Ky buletin botohet në bashkëpunim mes Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) dhe Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë.

Ekipi redaktues: Afrim Berisha (MMPH), Rizah Hajdari (MMPH), Abedin Azizi (UNDP) dhe Burbuqe Dobranja (UNDP).

SI MUND TË NDIHMONI NË MBROJTJEN E MJEDISIT!



Përdorni biçikletën ose transportin publik.



Përdorni sa më pak qese të plastikës.

